



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti i përmbushjes së obligimeve të
komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën
Janar – Dhjetor 2023



Prishtinë, 2024

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
1. KRITERET POLITIKE	7
1.1 Administrata Publike.....	7
1.2 Shoqëria civile	8
1.3 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit	9
1.4 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore	11
1. KRITERET EKONOMIKE	12
1.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut.....	12
1.2 Tatimet.....	12
1.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë	13
2. STANDARDET EVROPIANE.....	13
2.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale	13
2.2 Energjia	15
2.3 Mbrojtja e minoriteteve.....	19
2.4 Drejtësia, liria dhe siguria,	20
2.5 Menaxhimi i kufirit dhe migracioni.....	20
2.6 Arsimi dhe kultura.....	21
REKOMANDIMET.....	24

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
EVS	Ekipet Vepruese për Siguri
KE	Komisioni Evropian
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshillat Lokale për Siguri Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
PKIE	Programi Kombëtar për Integrim Evropian

Hyrje

Ky raport paraqet implementimin e obligimeve të komunave, që burojnë nga Agjenda Evropiane gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023. Duke pasur parasysh se Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës, Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal është e përkushtuar në përbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, MAPL ka zhvilluar disa mënyra të adresimit të çështjeve në nivel lokal për të shtyrë para agjendën evropiane, duke veçuar: koordinimin e procesit të planifikimit, hartimin e planit të përgjithshme për obligimet e komunave në procesin e integritit evropian, hartimin e planeve individuale të komunave si dhe hartimin e raportit të përbushjes së obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane për dy periudha brenda vitit Janar-Qershor dhe Korrik -Dhjetor.

Raporti ka rol të rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të nivelit lokal në fushën e Integritit Evropian, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunat në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare si dhe çdo grupi tjetër të interesit, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 kanë raportuar 33 komuna të Republikës së Kosovës ndërsa 5 komuna (Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mamushë) gjatë kësaj periudhe nuk kanë raportuar. Raporti është i bazuar në 55 veprime/masa dhe 177 pyetje/indikator që bien në përgjegjësi dhe kompetencë të komunave, për të cilat Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga komunat. MAPL në komuna ka adresuar të gjitha çështjet që burojnë nga Plani Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE), nga konkluzionet e nën komitetëve sektoriale si dhe nga sfidat e raportit të KE-së për Kosovën. Sa i përket strukturës së gjithmbarshme, raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike, standardet evropiane si dhe raporti pasqyron gjendjen reale të arriturave të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave për vitet në vijim.

Në kuadër të **kritereve politike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Administrata publike,
- Avokati i popullit,
- Shoqëria civile,
- Lufta kundër terrorizmit,
- Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 48% të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve politike.

Në kuadër të **kritereve ekonomike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut,
- Tatimet,
- Ndërmarrjet, politikat e industrisë dhe tregu i brendshëm.


Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 30 % të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve ekonomike.

Në kuadër të **standardeve evropiane**, prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Bujqësi dhe zhvillimi rural,
- Energji,
- Gjyqësori dhe të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve,
- Drejtësi,
- Liria dhe siguria,
- Menaxhimi i kufirit dhe migracioni,
- Arsimi dhe Kultura,
- Mjedis dhe mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 75 % të aktiviteteve të planifikuara në fushën e standardeve evropiane.

Në total komunat kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 51 % të obligimeve që burojnë nga Agjenda Evropiane, e që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale.



Grafikoni 1: Përmbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane


1. KRITERET POLITIKE

1.1 Administrata Publike

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kriterëve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Në kuadër të kësaj fushe, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr aktivitete lidhur me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën lokale, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, në 26 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Junik, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Graçanicë, Gjakova, Gjilani, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosova, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, Istog, Kamenicë, Partesh, Prizren) është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2023, ndërsa në 7 komuna (Deçan, Shtërpçë, Obiliq, Viti, Klllokot, Podujevë, Ranillug) nuk është hartuar programi i trajnimeve për periudhën raportuese.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, në pasqyrën e të dhënave të komunave mund të shohim se nga 33 komuna raportuese në 19 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Graçanicë, Gjakova, Gjilani, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Lipjan, Istog, Prizren) është hartuar Strategjia për Marrëdhënie me Publikun, ndërsa në 14 komuna (Junik, Dragash, Glllogoc, Prishtinë, Shtërpçë, Fushë Kosovë, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Viti, Kamenicë, Partesh, Klllokot, Podujevë, Ranillug) nuk është hartuar.



Grafikoni 2: Programit i trajnimeve dhe Strategjia për Komunikim me Publikun

Po ashtu planin vjetor të komunikimit deri më tani 24 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Glllogoc, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Viti, Kamenicë, Prizren, Podujevë) është hartuar plani vjetor i komunikimit

ndërsa në 9 komuna (Dragash, Shtërpçë, Graçanicë, Fushë Kosovë, Novobërdë, Istog, Partesh, Klllokot, Ranillug) ende nuk kanë hartuar. Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik, të gjitha 33 komunat raportuese zbatohet Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik. Mirëpo nëse shohim të dhënat e paraqitura në vijim mund të vërejmë që akoma nuk zbatohen dispozitat e U.A në nivel të duhur pasi që rezultatet e konsultimit publik me raportin e të gjitha propozimeve të ofruara nga qytetarët me sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve tjera të interesit publikohen në një numër të konsiderueshëm të Komunave.

Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit përcakton se në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësia/zyrtari për komunikim publik, në përputhje me këtë deri më tani në 29 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Drenas, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë) është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik ndërsa në 4 komuna nuk është caktuar ende zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik.

1.2 Shoqëria civile

Nga të dhënat e ofruara gjatë raportimit shohim se komunat në vazhdimësi kanë përkrahur shoqërinë civile duke i ofruar mbështetje dhe bashkëpunim. Nga të dhënat e pranuar një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Në 27 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Graçanicë, Gjakovë, Gjilan, Obiliq, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, Viti, Kamenicë, Prizren, Podujevë) buxheti i ndarë për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve është 3,278,527.52 euro, ndërsa në 6 komuna (Shtërpçë, Ferizaj, Istog, Partesh, Klllokot, Ranillug) nuk është ndarë buxhet. Me këtë mbështetje financiare janë përkrahur OJQ me 1,561 projekte.

Për nxitjen dhe stimulimin e aplikimit të OJQ-ve në projekte komunale komunat kanë ndërmarr edhe veprime si: *informimi në radio lokale, rrjete sociale dhe thirrje në ueb faqe të komunave, organizime të takimeve informuese për procedurat e aplikimit, ofrimi i ndihmës në plotësimin e dokumentacionit aplikues për gupet e OJQ-ve të cilat janë të marginalizuara, trajtim i barabartë dhe mos diskriminim i aplikuesve etj.* Komunat gjithashtu kanë përkrahur edhe projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Në 18 komuna (Klinë, Dragash, Pejë, Prishtinë, Graçanicë, Gjakova, Gjilani, Ferizaj, Obiliq, Suhareka, Malisheva, Shtime, Vushtrri, Lipjani, Istog, Kamenicë, Prizren, Podujevë) janë përkrahur 115 projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë në vlerë prej 427,875.98 euro.

1.3 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit

Një ndër objektivat më specifike e cila buron nga Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është edhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit, andaj më këtë qëllim në 14 komuna (Dragash, Glogoc, Hani i Elezit, Gjilan, Obiliqi, Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Istog, Viti, Partesh, Prizren, Podujevë) në bashkëpunim nivelin qendror dhe donatorë janë organizuar trajnime për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, dhe menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm, ndërsa në 19 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Pejë, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë Gjakovë, Ferizaj, Suharekë, Shtime, Novobërdë, Kamenicë, Kllokot, Ranillug, Fushë Kosovë) nuk janë organizuar trajnime.

Për mbështetjen dhe parandalimin e luftës kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, janë 17 komuna (Rahovec, Junik, Dragash, Glogoc, Hani i Elezit, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë) që kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpijë në ekstremizëm të dhunshëm si: *takime të rregullta përmes këshillave lokale dhe imamëve të xhamive lokale, takime me nxënës të shkollave të ndryshme, janë krijuar hapësirat e sigurta në shkolla për nxënësit që të bëjnë pyetje privatisht rreth çështjeve të ndjeshme sociale, fushata vetëdijesuese me qytetarët, aktivitete në terren, diskutime gjatë takimeve të rregullta me anëtarët e KKSB-së, takime me rinin, gra dhe strukturat arsimore me qëllim të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në rritjen e ekstremizmit me radikalizëm etj*, ndërsa në 12 komuna (Klinë, Skenderaj, Deçan, Pejë, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Gjakovë, Novobërde, Kllokot, Ranillug) nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim. Në 3 komuna (Obiliqi, Shtime, Vushtrri) nuk kanë ofruar informacione.

Në 29 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Gjakovë, Ferizaj, Obiliqi, Suharekë, Fushë Kosovë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Kllokot, Podujevë, Ranillug) nuk ka pasur raste të paraqitura në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Në 2 komuna (Glogoc, Graçanicë) nuk kanë ofruar informacion dhe në 2 komuna (Gjilan, Malishevë) ka pasur raste të raportuara.


Më qëllim të luftimit të korrupsionit, komunat në vazhdimësi në rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal kanë deklaruar rastet e konfliktit të interesit. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, në 28 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Glogoc, Hani i Elezit, Shtërpçë, Graçanicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliqi, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Kllokot, Ranillug) nuk ka pasur raste të paraqitura të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal. Në 2 komuna (Prishtinë, Podujevë) ka pasur 5 raste të paraqitura, ndërsa në 3 komuna (Pejë, Kaçanik, Vushtrri) nuk kanë ofruar informacione.

Sa i përket anëtarëve të kuvendit, që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës në 4 komuna (Junik, Peje, Kaçanik, Podujevë) numri i rasteve të paraqitura është 5 raste. Në 1 komunë (Fushë Kosovë) nuk kemi pranuar informacione, ndërsa në 28 komuna nuk ka pasur raste të tilla.

Plani Lokal për Integritet është hartuar në 28 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Glogoc, Pejë, Hani i Elezit, Prishtinë Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliqi, Suharekë, Malishevë, Shtime, Vushtrri,

Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë, Ranillug). Në 5 komuna (Prishtinë, Graçanicë, Fushë Kosova, Kllokot, Kaçanik) nuk është hartuar.

Pjesa më e madhe e komunave sipas raportimeve e kanë të caktuar zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit nga 33 komuna raportuese 25 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Junik, Dragash, Gllogoc, Pejë, Hani i Elezit, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliqi, Suharekë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë) kanë caktuar zyrtarin përkatës që raporton për Planin Lokal të Integritetit.



Grafikoni 3: Plani Lokal për Integritet dhe zyrtari i caktuar për planin e integritetit

Sa i përket implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, për krijimin e qasjes për shërbimin në gjuhët zyrtare janë 30 komuna (Klinë, Skenderaj, Shtime, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Gllogoc, Pejë, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosova, Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë, Ranillug, Kllokot) janë ndërmarrë këto veprime: *Te gjitha njoftimet, lajmet, komunikatat publikohen ne te dy gjuhët ne faqen e Komunës, ka përkthyes dhe kanë kontraktuar kompani të përkthimit, organizime të trajnimeve, pra kurse serbisht-shqip dhe shqip-serbisht etj.* Në 1 komune (Hani i Elezit) nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim, ndërsa 2 komuna (Kaçanik, Obiliqi) nuk kanë ofruar informacione.

Ashtu siç parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe në rregulloret komunale për gjuhët zyrtare, në 28 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Gllogoc, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliqi, Suharekë, Fushë Kosova, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, Istog, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë, Ranillug) publikohen të gjitha aktetet komunale në gjuhët zyrtare, 1 Komunë (Pejë) nuk ka ofruar informacione. Ndërsa në 3 Komuna (Hani i Elezit, Kllokot, Malishevë) nuk publikohen në gjuhët zyrtare.

1.4 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore

Në fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas të dhënave nga 33 komuna raportuese të komunave janë vetëm 7 komuna (Skenderaj, Obiliq, Vushtrri Rahovec, Deçan, Graçanicë, Prizren) të cilat kanë hartuar këtë plan.

Sfidat që 22 komuna (Klinë, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Graçanicë, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Viti, Kamenicë, Partesh, Klllokot, Podujevë, Ranillug, Istog) ende nuk e kanë hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Arsyet e mosmiratimit të këtij Plani kryesisht kanë qenë: *mungesa e mjeteve financiare, mungesa e sektorit të veçantë të trashëgimisë, mungesa e ekspertëve, stafit etj.* Gjatë kësaj periudhe numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura në 4 komuna (Istog, Viti, Prizren, Podujevë) është 8 shkelje.

Po ashtu, në 13 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosovë, Lipjan, Prizren, Klllokot, Podujevë) janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave te objekteve të trashëgimisë kulturore, në 12 komuna (Glllogoc, Pejë, Hani i Elezit, Shtërpçë, Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Viti, Kamenicë, Partesh, Ranillug) nuk janë siguruar. Në 3 komuna (Prishtinë, Obiliq, Shtime) nuk kanë ofruar informacione, ndërsa 1 komunë (Istog) pjesërisht.

Në 4 Komuna (Klinë, Skenderaj, Ferizaj, Fushë Kosovë) janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse. Në 19 komuna (Deçan, Pejë, Shtërpçë, Graçanicë, Gjakovë, Gjilan, Obiliq, Shtime, Vushtrri, Lipjan, Novobërdë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë, Ranillug) nuk janë nënshkruar. Në 3 komuna (Dragash, Glllogoc, Hani i Elezit) nuk ka kisha. Ndërsa 7 Komuna (Kaçanik, Prishtinë, Suharekë, Malishevë, Mitrovicë Jugore, Junik, Rahovec) nuk kanë ofruar informacione.

Për funksionimin e Këshillit të fshatit për Hoqën e Madhe, komuna e Rahovecit i ka përfunduar me kohë të gjitha procedurat për themelimin e këtij këshilli. Ky këshill është funksional dhe mbanë takime të rregullta. Komuna e Rahovecit për çdo vit ndanë buxhet për këtë Këshill në vlerë 29.000 euro.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar – Dhjetor 2023 komuna e Prizrenit nuk ka alookuar buxhet, nuk ka pasur asnjë ndërtim ilegal brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit. Është filluar procesi i legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje si dhe janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit. Projekti “Regjenerimi dhe rehabilitimi i brigjeve dhe urave” është në ekzekutim e sipër.

Në Komunën e Fushë Kosovës është bërë studimi i fizibilitetit për themelimin e Muzeut të Natyrës i cili është duke u ndërtuar në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sportit por ndërtimi ende nuk ka përfunduar.

Gjithashtu me qëllim për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore komunat kanë ndërmarrë aktivitetet të ndryshme. Në 29 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani i Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosovë, Shtime, Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë) janë ndërmarrë veprime si: *Promovimi i asetëve të trashëgimisë në media televizive, postimet e fotografive nga asetet e trashëgimisë kulturore, është bërë projekti për restaurimin e disa objekteve të trashëgimisë kulturore mbështetje e projekteve dhe*

të individëve, festivale folklorike, aktivitete kulturore, vizita në Muzeume, promovime të ndryshme, etj. Në 4 komuna (Novobërda, Ranillug, Kllokot, Obiliq) nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet.


1. KRITERET EKONOMIKE

1.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut

Për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët është paraparë krijimi i qendrave për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et) të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese përfshirë regjistrimet e tyre. Në 29 komuna janë funksionale, ndërsa në 4 Komuna (Kllokot, Partesh, Prishtinë, Ranillug) nuk janë themeluar.

Numri i inspektorëve të tregut në 27 komuna është 57, ndërsa janë 4 Komuna (Deçan, Prishtinë, Junik, Shtërpçë) nuk ka inspektor, dhe 2 Komuna (Shtime, Vushtrri) nuk ka ofruar të dhëna. Gjithashtu numri i inspektimeve në 26 komuna është 8,629 inspektime, ndërsa 2 Komuna (Kllokot, Kaçanik) nuk ka pasur asnjë inspektim.

Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 30 komuna janë mbajtur 281 dëgjime publike , kurse në 3 komuna (Shtërpçë, Dragash, Ferizaj) nuk janë mbajtur.



Grafikoni 4: Numri i dëgjimeve publike për planifikim të buxhetit

1.2 Tatimet

Me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale në 27 komuna janë ndërmarr veprime si: *kontrolltet e vazhdueshme tek bizneset lidhur me lëshimin e kuponëve fiskal, Mbyllja e subjekteve ilegale deri në kompletimin e dokumentacionit adekuat për ushtrimin e veprimtarisë, Obligimi i bizneseve për tu regjistruar pranë ARBK, produkteve të cilat kanë qenë pa deklaracion në gjubën zyrtare janë larguar nga shifja kurse produktet që kanë qenë pa origjinë janë sekuestruar dhe asgjësuar në prani të*

personave që kanë bërë tregtimin e tyre në mënyrë të pa ligjshme, vërejtje, inspektime mbi posedimin certifikatave të regjistrimit të bizneseve, inspektim dhe kontrolle të vazhdueshme të lokaleve afariste, mbyllja e subjekteve ilegale, ofrimi i këshillave të nevojshme për të operuar ligjshëm etj, ndërsa 6 komuna (Klllokot, Ranillug, Shtërpcë, Prishtinë, Deçan, Obiliq) nuk kanë ofruar të dhëna.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2023, nga 33 komuna raportuese 26 prej tyre kanë pranuar 289 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm. Prej tyre të adresuar janë 179 rekomandime, të pa adresuara mbesin 25 rekomandime dhe pjesa tjetër gjenden në proces.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 30 komuna, ndërsa 3 komuna (Ranillug, Klllokot, Partesh) nuk funksionon. Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 28 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale, ndërsa në 5 komuna (Partesh, Klllokot, Graçanicë, Obiliq, Novobërdë) nuk është publikuar.

Në 25 Komuna (Istog, Viti, Kamenicë, Prizren, Podujevë, Klinë, Skenderaj, Rahovec, Junik, Dragash, Glllogoc, Pejë, Prishtinë, Shtërpcë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore) është themeluar komiteti për auditim, ndërsa në 8 Komuna (Partesh, Klllokot, Ranillug, Hani Elezit, Graçanicë, Deçan, Kaçanik, Novobërdë) nuk është themeluar.

1.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

Në 11 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, ndërsa në 20 Komuna (Viti, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë, Ranillug, Klinë, Junik, Pejë, Hani Elezit, Deçan, Graçanicë, Kaçanik, Prishtinë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Malishevë, Vushtrri, Novobërdë, Gjilan,) nuk është bërë funksionalizimi, në 1 Komunë (Shtime) është bërë pjesërisht dhe 1 Komunë (Kamenicë) nuk ka zona ekonomike.

2. STANDARDET EVROPIANE

2.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale

Në sektorin e bujqësisë sfidë e theksuar mbetet hartimi i dokumenteve për rregullimin e mëtejshëm të tokave bujqësore pasi që nga 30 Komuna raportuese vetëm në 12 komuna (Rahovec, Junik, Dragash, Glllogoc, H, i Elezit, Graçanicë, Kamenicë, Prizren, Podujevë, Gjakovë, Ferizaj, Malishevë) është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ndërsa në 21 komuna (Klinë, Skenderaj, Deçan, Pejë, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpcë, Istog, Viti, Partesh, Klllokot, Ranillug, Gjilan, Obiliq, Suharekë, Fushë Kosovë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë) ende nuk është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 në 26 komuna (Skenderaj, Rahovec, Deçan, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpcë, Graçanicë, Viti, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë, Ranillug, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Lipjan, Novobërdë) numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore është 1548, ndërsa 7 komuna (Klinë, Junik, Istog, Kamenicë, Suharekë, Mitrovicë Jugore, Viti) nuk ka pasur kërkesa të parashtruara.. Krahas kësaj lidhur me këto kërkesa janë nxjerr 448 vendime nga 25 komuna (Skenderaj, Rahovec, Deçan, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani Elezit,

Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Viti, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë, Ranillug, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Fushë Kosovë, Shtime, Lipjan, Novobërdë), ndërsa në 8 komuna (Klinë, Junik, Istog, Kamenicë, Suharekë, Mitrovicë Jugore, Malishevë, Vushtrri) nuk ka pasur asnjë vendim të miratuar.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në 25 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Dragash, Junik, Glllogoc, Pejë, Hani Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Graçanicë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Klllokot, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë) janë funksionalizuar këto qendra, ndërsa në 8 komuna (Deçan, Shtërpçë, Prizren, Podujevë, Ranillug, Gjakovë, Gjilan, Vushtrri) nuk janë funksionalizuar.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së tokave bujqësore, në 30 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Junik, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë, Ranillug, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë) është ofruar mbështetje për 7,850 fermer në sektorin e bletarisë, blegtorisë, perimtarisë, shpezetarisë, hortikulturës, ndërsa 3 komuna (Klllokot, Deçan, Vushtrri) nuk janë mbështetur.

Sa i për ketë inspektorëve të bujqësisë, në 8 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Glllogoc, Pejë, Klllokot, Shtime, Lipjan) ka inspektor të bujqësisë, ndërsa në 25 komuna (Deçan, Junik, Dragash, Hani Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë, Ranillug, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Obiliq, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Graçanicë) nuk ka asnjë inspektor të bujqësisë. Në shumicën e komunave ku nuk ka inspektor të bujqësisë në këto raste inspektimet realizohen nga inspektori sanitar, inspektori regional, inspektori i veterinarisë, inspektori komunal, inspektori i ndërtimit, inspektorët nga Zyra Rajonale e AUVK-ut, nga niveli qendror, koordinatori i bujqësisë. Numri i inspektimeve bujqësore në 9 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Glllogoc, Ranillug, Obiliq, Shtime, Lipjan, Novobërdë) është 1,511 inspektime. Në 11 komuna (Deçan, Pejë, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Gjakovë, Gjilan, Suharekë, Malishevë, Mitrovicë Jugore) nuk ka pasur asnjë inspektim, ndërsa 13 komuna (Junik, Hani Elezit, Graçanicë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Vushtrri) nuk kanë ofruar informacione.

Në 10 komuna (Skenderaj, Rahovec, Dragash, Shtërpçë, Istog, Viti, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë Jugore, Lipjan) ka pasur raste të humbje të tokës bujqësore, ndërsa në 8 komuna (Klinë, Junik, Glllogoc, Gjakovë, Gjilan, Suharekë, Novobërdë, Kamenicë) nuk ka humbje të tokës bujqësore, dhe 14 komuna (Deçan, Hani Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Graçanicë, Partesh, Prizren, Klllokot, Ranillug, Ferizaj, Obiliq, Malishevë, Shtime, Vushtrri) nuk kanë ofruar informacione.

Në 10 komuna (Skenderaj, Rahovec, Dragash, Shtërpçë, Istog, Viti, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë Jugore, Lipjan) në të cilat ka pasur raste të humbjes së tokës bujqësore është ndërtuar shtrati i lumit, janë kryer inspektime, është bërë ndërprerja e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe ka pasur gjoba etj.

Planin për Menaxhimin e tokave rurale e posedojnë 4 Komuna (Pejë, Dragash, Graçanicë, Shtime). 2 komuna (Kamenicë, Prizren) këtë çështje e kanë të rregulluar në kuadër të PZHK, ndërsa 27 komuna tjera ende nuk është hartuar Plani për menaxhimin e tokave rurale


2.2 Energjia

Me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA komunat në vazhdimësi kanë bërë zhvillime të mëtejme në politikat e fushës së efikasitetit të energjisë. Planin për Efikasitet të Energjisë e kanë hartuar 17 komuna (Rahovec, Junik, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani Elezit, Shtërpçë, Viti, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë, Gjakovë, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Novobërda), ndërsa në 16 komuna (Klinë, Skenderaj, Kaçanik, Prishtinë, Gjilani, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjani, Istog, Kamenicë, Ranillug, Deçan, Graçanicë) ende nuk është hartuar ky Plan.

Me qëllim të zbatimit të këtij plani, në 25 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Junik, Dragash, Glllogoc, Pejë, Hani Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë, Ranillug, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Malishevë, Mitrovicë Jugore, Lipjan) ka pasur projekte në masat e zbatimit të efikasitetit. Disa nga projektet janë: Vendosija e poqeve eficient në qytet dhe në fshatra, nënshkrimi i projektit për Shërbime të Energjisë ESKO, Izolimi i objekteve arsimore dhe objekteve të tjera publike me masat për efikasitet të energjisë, Ndërrimi i trupave ndriçuese me trupa eficientë – LED, ndërtimi i sistemeve të reja të ngrohjes qendrore nëpër objektet publike etj. Në 8 komuna (Vushtrri, Novobërdë, Deçan, Graçanicë, Istog, Klllokot, Fushë Kosovë, Shtime) nuk ka pasur asnjë projekt.

Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Në kuadër të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi komunat janë të obliguar të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij ligji dhe sipas të dhënave zyrtare mund të shohim se deri më tani në 25 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Hani Elezit, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan) është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen e diskriminimit, ndërsa në 8 komuna (Glllogoc, Pejë, Kaçanik, Viti, Klllokot, Ranillug, Obiliq, Suharekë) nuk është emëruar. Sa i përket zyrtarit përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në 30 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Pejë, Hani Elezit, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë, Ranillug, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan) është emëruar zyrtari, ndërsa në 3 komuna (Glllogoc, Obiliq, Suharekë) nuk është emëruar zyrtari përkatës. Kurse zyrtari për barazi gjinore është caktuar në 29 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Glllogoc, Dragash, Hani Elezit, Shtërpçë, Graçanicë, Istog, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Podujevë, Ranillug, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë), ndërsa në 4 komuna (Pejë, Kaçanik, Prishtinë, Klllokot) nuk është emëruar zyrtari përkatës.



Grafikoni 5: Caktimi i zyrtarëve për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi

Në 14 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Dragash, Pejë, Kaçanik, Istog, Ranillug, Obiliq, Fushë Kosovë, Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan) janë ndarë mjete buxhetore me shumë prej 110.640, 00 euro për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ndërsa në 19 komunat tjera (Junik, Glllogoc, Shtërpçë, Viti, Kamenicë, Partesh, Prizren, Klllokot, Podujevë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Suharekë, Shtime, Novobërdë, Deçan, Hani Elezit, Prishtinë, Graçanicë) nuk është ndarë buxhet.

